

Prof. dr. Sabile Keçmezi-BASHA

**Lidhja Shqiptare e Prizrenit në programet e organizatave
ilegale shqiptare në Kosovë (1945-1990)**

Që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878), në botën shqiptare ekzistonte një program kombëtar i ruajtjes së tërësisë së atdheut, dhe i bashkimit kombëtar, mbi bazën e të cilit ishin hartuar gjithë programet e Lëvizjes Kombëtare në vijim, kërkesa këto, që vazhduan të prezantohen edhe në programet e lëvizjes ilegale, në vitet e mëvonshme.

Do të citoja një mendim të prof. Zekiria Canës, i cili thotë se LSHP kishte tri pikësnyime kryesore: Shkundjen e zgjedhës osmane, pavarësinë kombëtare dhe bashkimin e të gjitha trojeve etnike brenda një shteti¹. Andaj, nga kjo del se, ky qëllim programor mbeti i pa ndryshuar në thelb, edhe në programin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit (1943), por edhe më vonë, pas mbarimit të LDB. Pikësnyimi i parë mbeti po ashtu zgjedha nga okupuesi, por kësaj radhe nga okupimi sllavë. Gjithashtu, pavarësia kombëtare dhe bashkimi i të gjitha trojeve shqiptare ishin thelbësore për lëvizjen ilegale. Sepse, e tërë kjo buronte nga e drejta legjitime dhe e natyrshme për të qenë të bashkuar dhe të barabartë me popujt tjerë.

¹ Zekeria Cana, *Porosit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për çështjen kombëtare*. (Përmbledhje punimesh "Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe vendi i saj në histori"), Prishtinë, 2008, f.317.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (1912), problemi i Kosovës dhe i viseve të tjera të banuara nga shqiptarët në ish-Jugosllavi, jo vetëm që nuk u zgjidh, por përkundrazi, atyre iu mohua çdo e drejt për të vetëvendosur, si rrugën e vetme për zgjidhjen përfundimtare të problemit kombëtar.

Pas aneksimit të Kosovës, për popullin shqiptar filloi një etapë e errët, një kalavar i vërtetë. Filluan përsëri masakrat masive mbi popullatën e pafajshme, dhe likuidoheshin patriotët dhe intelektualët e paktë. Edhe pse ishte pushtuar, Kosova trajtohej vazhdimisht si zonë e rrezikshme dhe e pa sigurt për shkak se banohej me një popullsi jo sllave. Me këtë gjendje të imponuar, ku “liria” dhe “barazia” e popullit shqiptar ishin shndërruar në robëri nga një pakicë kombëtare-serbët dhe malazezët, kuptohet se populli liridashës nuk ishte i kënaqur. Meqë shqiptarët e Kosovës përgjatë tërë kufirit me shtetin amë, edhe zyrtarisht ishin shpallur si element i pabesueshëm, për këtë arsye edhe ndiqeshin, burgoseshin, torturoheshin, detyroheshin të shpërnguleshin, madje edhe vriteshin dhe askush nuk merrej në përgjegjësi. Fundja të gjitha masakrat, që iu bënë shqiptarëve, ishin të zyrtarizuara nga organet shtetërore, që si bazë u shërbenin “Naçërtania” e Garashaninit, Elaboratet e I. Andriqit, I. Vukotiqit, Elaboratet I e II të Vasa Çubrilloviqit. Të cilat vazhduan të zbatohen me përpikëri deri më 1999.

Duhet përmendet se, edhe pas përfundimit të LDB, organizatat ilegale të cilat filluan të vepronin në Kosovë karakterizohen me programet e tyre që kryesisht kishin mbështetje në kërkesat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Organizata e cila bëri bujë dhe emër me veprimtarin e saj patriotike gjatë viteve 1945 e deri më 1956 ishte ONDSH-në, e cila veprimtarin e saj e shtrinte në Kosovë dhe në pjesën Lindore të Maqedonisë, duke u përcaktuar për luftë të armatosur kundër robërisë së re jugosllave dhe formimit të një shteti shqiptar me territoret e veta. Kishte një politik nacionale e demokratike pro-perëndimore, dhe kryesisht udhëhiqej nga patriot dhe intelektual të shquar si Ymer Berisha, Halim Spahiu, Selman Riza, Gjon Serreqi e

shumë të tjerë. Programi i saj ishte i përbërë prej pesë pikave të cilat kryekëput përputheshin me pikat e LSHP.

Do të citoja vetëm disa nga pikat kryesore të programit të kësaj organizate siç janë të shënuara:

1. Liri dhe pavarësi të plotë me të drejtë vetëqeverimi në bazë të vullnetit të popullit të çfaqun lirisht.

2. Nën tokat shqiptare kuptohet krejt vendet ku banojnë shqiptaret në 60% pa dallim se si quhet krahina e vendi dhe nga kush asht i pushtuem.

3. Lëvizja nuk ka qëndrim armiqësor kundër asnjë populli fqinj as kundër partije politike, vetem insiston në mënyrë kulturave dhe me armë do të përpiqet mi arrijtë idealet shekullore të kombit Shqiptar qi të jetë i lirë dhe vetesundues në shtet të vet me kufij etnik.

4. Mbasi të vendosen kufijt etnik, pa marr parasysh tjerat kushte të kufijve si janë ato: strategjike, ekonomike, politike etj, në mënyrë miqësore do te shkëmbehet popullata e pakicave nacionale, tue i tërheq Shqiptaret qi do te mbetin jasht kufijve në vend të aryne qi do ti shpërngulin tue u organizue për regjim me të vërtet demokratik dhe për relacione miqësore me popujt fqj Ballkanik

5. Në kohë paqe Lëvizja nuk do të pushojë por do te vazhdojë si shërbim roje të drejtave të popullit Shqiptar, si t'atyne të jashtme, nderkombtare tue u organizue për regjim me të vërtet demokratik dhe për relacione miqësore me popujt fqj Ballkanik.

Menjëherë pas arrestimit të anëtarëve të organizatës së NDSH-së (1947), në Kosovë filloi të riorganizohej dhe të konsolidohej Lëvizja ilegale në teren. Por, ndodhte shpesh organizatat e sapo formuara, edhe pse kishin vazhdimin e NDSH-së, ato filluan të quheshin me emra tjerë. Bile për të qenë sa më besnike ndaj kërkesave të LSHP, në disa pjesë të Kosovës e Dukagjinit organizatat u pagëzuan me emrin e LSHP, siç kishte ndodhur me një grup nacionalistësh, që formacionin ilegal e pagëzuan me emrin "Grupi i

Lidhjes së Prizrenit”², e cila programin e vet e mbështete në kërkesat e LSHP, që për bazë kishte të vërtetën historike, të drejtën për të jetuar i lirë në tokën e vet, dhe në parimet e demokracive perëndimore. Vazhdimisht, duke iu referuar dokumenteve të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, thuhej se Organizata “Lidhja e Prizrenit”, ishte formuar diku në muajt e verës të vitit 1949, nga anëtarë të pjekur politikisht dhe që të gjithë ishin atdhetar të shquar dhe që kishin eksperiencë të bollshme politike. Bile, disa nga anëtarët e organizatës qysh më herët kishin qenë anëtarë të një organizate ilegale që kishte vepruar më herët (1945-1947), në Prizren.

Siç e thamë më lart, organizata ishte formua me 1949, ndërsa veprimtaria dhe anëtarët e saj u zbuluan me 1950.³ Disa nga anëtarët e saj u arrestuan dhe u dënuan në procesin gjyqësor të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, më 1950.

Pushtetarët, duke e parë se situata politike në rrethin e Prizrenit në vitet e pas luftës e deri më 1950, po iu ikte nga dora dhe veprimtaria atdhetare e ilegale po shtohej dita më ditë, udbashët filluan me të madhe të shtonin survejimin dhe të përcillnin çdo atdhetar se kah shkonte dhe se me çfarë po merrej. Përcjellja e udbashve ishte e thellë dhe shumë e fshehtë, andaj nuk vonoi shumë dhe në muajt shkurt e mars nëntë anëtarë të organizatës “Lidhja e Prizrenit” u hodhën në burgun hetues të Prishtinës.

Veç tjerash, organizata kishte edhe programin e vet të quajtur “Dymbëdhjetë pikat”. Në këtë program, bëhej fjalë që: 1. çdo anëtar para se të pranohej në organizatë duhej ti plotësoj këto kushte: 1. Duhet të jetë i vendosur për ruajtjen dhe formimin e kombit shqiptar, 2. të jetë i disiplinuar, i vendosur për marrjen dhe kryerjen e detyrave që e ngarkon organizata. 3. Duhet të jetë agjikator dhe propagandues, konspirativ dhe i përgatitur për çdo gjë deri në pikën e fundit. 4. Duhet të jetë konsekuent në qëllimet e aspiratave të popullit shqiptarë

2 Besim Morina, “Grupi i Lidhjes së Prizrenit”, (E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë etnike-(4), Prizren-Klinë, 2006, f. 389.

3 Aktygjimi i anëtarëve të organizatës ilegale “Grupi i Lidhjes së Prizrenit”, 1950.

deri në vet sakrificë. 5. Duhet të jetë i gatshëm që me pushkë në dorë, të luftojë kundër të huajve që okupuan tokat shqiptare, duke bashkëpunuar me aleatet dhe duke i bashkuar të gjithë shqiptaret rreth flamurit kombëtar kuq e zi.

Në këtë periudhë edhe pse ishte konsoliduar deri diku ONDSH-ja, më 1957 u formuan dhe vepruan si: Organizata ilegale e atdhetarit Metush Krasniqi me emrin simbolik "Partia revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me shtetin amë". Në qershor të të njëjtit vit, Metush Krasniqi para anëtarëve të vet kishte paraqitur Programin e punës të Partisë, ku pos angazhimeve të tjera, ai si kusht themelor e parimor kishte paraqitur rendësin e lirisë, por mbi të gjitha atë të bashkimit kombëtar me shtetin amë, duke lejuar për të përdorur të gjitha mjetet dhe metodat. Në këtë drejtim kishte hartuar planin për propagandimin e idesë për bashkimin me Shqipërinë.

Organizata "Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë", u formua në muajin maj të vitit 1960. Duhet cekur se vitet e 50 e të 60 ishin vite shumë të rënda për shqiptarët që kishin ngelur nën Jugosllavi. Në këtë gjendje ndikim të dukshëm kishte luajtur edhe prishja e marrëdhënieve në mes shteteve socialiste dhe Jugosllavisë, apo siç njihej ndryshe koha e Informbyrosë. Duke e ndjerë robërinë edhe më tepër mbi kurrizin e popullit, disa intelektual kishin marr përsipër që të formonin një organizatë ilegale të cilën e pagëzuan me emrin shumë simbolik dhe transparent për qëllimet e tyre "Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë". Në mbledhjen themeluese, kryetar i saj një zëri u zgjodh Kadri Halimi, profesor në Universitetin e Beogradit.

Veprimtaria e kësaj organizate u zhvillua kryesisht në formë treshesh, dhe në bazë të dokumenteve shihej se kishte një shtrirje të gjerë. Edhe kjo organizatë sikurse edhe organizatat tjera ilegale kishte programin e saj që kryesisht e mbështeste në kërkesat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të Lidhjes së Pejës, Konferencës së Bujanit dhe të Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare.

Ndërsa, më 1963 formohet një organizatë tjetër me emrin “Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve”, e udhëhequr nga Adem Demaqi. Më vonë, kjo organizatë kishte përgatitur edhe Programin. Programi i kësaj organizate, kishte dy pika kryesore, në të cilën prezantonin karakterin e luftës së kësaj organizate dhe në katër pika kishin përfshi plotësimin e kushteve themelore, që po ashtu edhe këto kushte kishin vazhdimësinë nga kërkesat e LSH të Prizrenit.

Pikat kryesore të luftës në këtë program kishin:

1. Karakter të bashkimit kombëtar
2. Karakter të çlirimit kombëtar.

Ndërsa plotësimi i kushteve elementare të programit të kësaj organizate ishin:

1. me qenë i bashkuem territorialisht;
2. me pas një treg të përbashkët ekonomik;
3. me pas një gjuhë të përbashkët letrare;
4. me qenë i përshkuam nga ndjenjat e dashurisë, përkatësisë dhe solidaritetit reciprok vëllazëror⁴

Nën pikën 1 e 2, të programit theksohej se: “Qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë është sigurimi i të drejtës për Vetëvendosje deri në shkëputje për viset e banuara në shumicë prej shqiptarëve që gjinden ende nën administrimin e Jugosllavisë, domethënë qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë asht- Çlirimi i krahinave, të aneksuara prej Jugosllavisë dhe bashkimi i këtyre krahinave me nënën e vet- Shqipërisë”.

Veç këtyre organizatave, në Kosovë dhe në trojet tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi do të formohen dhe do të vepronin edhe disa grupime më të vogla ilegale-politike që për qëllim parësorë do të kenë kërkesat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, çka nënkupton bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare në një shtet.

⁴ Programi Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, 1964, Gjykata e Qarkut, Prishtinë.

Në vitet e gjashtëdhjeta, pjesa dërmuese e shqiptarëve edhe më tej ishin të pakënaqur, gjatë këtyre viteve u formuan dhe vepruan shumë grupe e organizata ilegale. Qëllimi suprem i të gjithave ishte që territori i Kosovës dhe viset tjera të Maqedonisë dhe të Malit të Zi të banuara me shqiptar të shkëputeshin nga Jugosllavia dhe ti bashkëngjiteshin Shqipërisë.

Organizata ilegale grupi Marksist-Leninist i Kosovës u mbeti besnik parimeve dhe programit të përcaktuar nga Grupi Revolucionar dhe duke kërkuar të mobilizonte popullin për liri dhe për bashkim kombëtar. Mirëpo, pas ndryshimeve të shumta politike, grupi Marksist-Leninist i Kosovës kishte vendosur që të ndërronte strategjinë për realizimin e e qëllimit përfundimtar. Prandaj u vendos që të lëshohej në qarkullim parulla "Kosova-Republikë". Për këtë qëllim edhe u hartuan "Tezat mbi frontin për Republikën e Kosovës" të shtruara në rreth 260 faqe. Mesazhi që vije nga këto teza ishte se që të gjithë shqiptaret dhe të gjitha organizatat legale e ilegale, brenda dhe jashtë vendit duhet të bashkoheshin në një front të përbashkët për të arritur qëllimin suprem. Duhet theksuar se programi i tyre ka rëndësi të madhe historike se përqendrohet në faktin se kishte për qëllim çlirimin nga okupuesi serb dhe organizimi i mbrojtjes kombëtare të Kosovës si Republikë.

Pas vitit 1970 deri më 1981, organizatat ilegale do të karakterizohen me një artikulum të ri të koncepteve politike e kombëtare.

Deri në vitin 1968, ndonëse të gjitha organizatat politike ilegale kishin si synim çlirimin e Kosovës me viset tjera shqiptare dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë, pa hequr dorë nga ky qëllim, në programet e tyre do të fusin si kërkesë dhe do të angazhohen edhe për jetësimin e opsionit të Republikës, të përfshirë këtu në Kosovë dhe viset tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi dhe kjo do të jetë shkalla e parë për realizimin e bashkimit kombëtar.

Mbas demonstratave të vitit 1968, shumë atdhetar e intelektual rënë në burg. Por, gjatë viteve të 70-80, ilegalja e Kosovës përsëri u

këndell dhe mori veten. Gjatë kësaj periudhe u formuan organizata të reja që po ashtu u angazhonin dhe luftonin për lirin e tokave shqiptare nën ish- Jugosllavi. Në këtë kohë u organizua dhe veprimi i organizatave ilegale “Grupi Revolucionar i Kosovës” që më vonë u shndërrua në “Organizatë Marksiste- Leniniste të Kosovës”. GRK programin e tij e ndërtonte mbi bazë të çlirimit kombëtar dhe të bashkimit të atdheut të copëtuar padrejtësisht. Ky përkufizim i programit përjashtonte çdo mundësi cilësimi të tij si ekstremist, majtist a reaksionar.⁵

Edhe “Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi” (verë 1978), kishte programin e vet i cili bazohej në të dhënë se Kosova duhej të fitonte statusin e e republikës në kuadër të Jugosllavisë, por duke përfshirë të gjitha territoret e banuara me shqiptar. Pika kryesore e këtij programi ishte që Kosova të fitojë të drejtën për vetëvendosje, ngase nga e drejta për vetëvendosje, fitohej edhe e drejta për realizimin e aspiratave shekullore të shqiptarëve për bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare.

Edhe organizata “Lëvizja për Çlirimin Kombëtar të Kosovës”, në programin e saj, rëndësi të veçantë i kishte kushtua çlirimit kombëtar të Kosovës dhe bashkimit të të gjitha trojeve shqiptare me shtetin amë.

Ndërsa, pas vitit 1981 e deri më 1990, formohen grupe e organizata ilegale, që kishin ngjyrimet e ndryshme ideologjike, të cilat i kishte nxjerrë koha, por pa marr parasysh se çfarë ngjyrimesh kishin ato edhe në këtë periudhë, programet e tyre kishin mbështetje në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe me fillimin e viteve të '90, në kohën kur zë fill formimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo edhe është periudha më e rëndësishme e saj: është përmbyllje kulminante e një lëvizjeje të gjatë ilegale që në çdo kohë dhe periudhë paraqiti kërkesat e LSHP, që duhej të përmbusheshin.

Që të gjitha organizatat ilegale që vepruan në këtë periudhë,

⁵ Mehmet Hajrizi, *Organizata ilegale dhe demonstratat e vitit 1981*, Tiranë 2008.

mund të thuhet se punonin në bazë të Programeve politike dhe kishin Statutet e tyre, që synimet e tyre ishin thjesht të karakterit kombëtar dhe qëllimi suprem ishte mëvetësia e Kosovës dhe bashkimi me Shqipërinë.

Dhe krejt në fund, mund të themi se të gjitha organizatat ilegale atdhetare që nga viti 1945-1990, angazhoheshin për një Shqipëri të bashkuar në hapësirën e saj historike e etnike, të një shteti sovran, të lirë e demokratike, të përcaktuar sipas vullnetit të qytetarëve, në të cilin do të jetonin të lirë, të barabartë e në mirëqenie gjithë qytetarët, pa dallim feje, kombësie, gjuhe, krahine apo çfarëdo përkatësie tjetër qofshin.

SUMMARY

REPRESENTATION OF THE ALBANIAN LEAGUE OF PRIZREN ON PROGRAMS OF ALBANIAN ILLEGAL ORGANIZATIONS IN KOSOVA (1945-1990)

After the declaration of Albania's Independence (1912), problem of Kosova and other Albanian lands in former Yugoslavia, not only remained unsolved but escalated because of negation of the right of self-determination as the final solution to national problem. Historically, our people's 95-years old experience shows how injustice of international character caused hardship.

Illegal political activity of Albanians in former Yugoslavia between 1945 and 1990 could be divided in several phases;

The first phase, stretching between 1944 and 1950 mainly characterized with activities of LNDSH (Albanian National Democratic Movement).

The second phase between 1950 and 1958, when diverse illegal organizations loomed, beginning with LNDSH continuation and formation of other organizations of liberation character.

From 1958 to 1968 begins the third phase of illegal organizations based on articulation of new political and national conceptions.

Final, fourth phase of illegal activity in Kosova 1969-1981 when were formed groups and organization of diverse ideological affiliations which converged in time.

Regarding evaluation of all organizations and illegal groups active in Kosova for having a Marxist – Leninist orientation one

should take into consideration circumstances of time, the fact of Albania having such regime in power.

Whilst the fourth phase of illegal movement in Kosova begins with major historical shift on 1981 and ends in the 1990-es, when Kosova Liberation Army (KLA) has been formed. This is most important phase of illegal movements in Kosova and other parts of former Yugoslavia. Protests of 1981 represent a calling for Albanian people and international opinion.

It could be concluded that all illegal patriotic organizations aimed for a united Albania within its historical and ethnical territories, as a sovereign, free and democratic state determined by the will of citizens, in which they would live free and equal, no matter of religious, ethnical, language or provincial backgrounds.

should take into consideration the historical role of the Albanian people in the Balkans.

While the fourth phase of development in Kosovo began with major historical shifts in 1981 and ends in the 1990s, the Kosovo Liberation Army (KLA) has been formed. This is an important phase of the development in Kosovo and other parts of the Balkans.

It could be concluded that the Albanian people are organized and aimed for a united Albania with territorial and ethnic integrity as a sovereign, free and democratic state established by the will of citizens in which they would live free and equal, on a basis of mutual respect and tolerance.

Albanian people have a long history of struggle for freedom and independence. In the 19th century, the Albanian people were the first to rise against the Ottoman Empire. In the 20th century, they fought for independence from Yugoslavia and the establishment of the People's Republic of Albania.

Legal political activity in Albania is divided into several phases: 1945-1991 and 1991-1994.

The first phase, stretching between 1944 and 1991, is mainly characterized by the activities of the National Democratic Movement (NDM).

The second phase, between 1991 and 1994, is characterized by the activities of the National Democratic Movement (NDM) and the National Democratic Movement (NDM).

The third phase, between 1994 and 1997, is characterized by the activities of the National Democratic Movement (NDM) and the National Democratic Movement (NDM).

The fourth phase, between 1997 and 1998, is characterized by the activities of the National Democratic Movement (NDM) and the National Democratic Movement (NDM).

Regarding the role of the National Democratic Movement (NDM) in the development of the Albanian people, it is clear that the NDM has played a significant role in the development of the Albanian people.